



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 3, Datë 24.09.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALIT “BALLENJË”, NË KOMUNËN MARTANESH, QARKU DIBËR

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentralit “Ballenjë” për shoqërinë koncesionare “Ballenja Power Martanesh” Sh.p.k.
2. Bashkëlidhet materiali i plotë grafik, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENTI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

